



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

J@B NET
Fitnete Mujaj
Drejtoreshë
Pejë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2023/171 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për J@B NET (Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. Pala përgjegjëse me datën 26 shkurt 2015, është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Jabllanicë e Vogël-Pejë. Me marrjen e Operatori i Shpërndarjes J@B Net është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM me datën 3 nëntor 2020 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve të shpërndarjes (OSH), të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale, sigurimi i qasjes në shërbimet audio dhe audiovizuale për të gjithë përdoruesit në baza transparente, objektive dhe jo diskriminuese, mbrojtja e interesave të të gjithë përdoruesve të shërbimit, sigurimi i nivelit të cilësisë së shpërndarjes së përmbajtjeve audio dhe audiovizuale në përputhje me standardet e përgjithshme të pranura në Bashkimin Evropian, si dhe promovimi i konkurrencës në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizuale, në mënyrë që publikut t'i ofrohen shërbime me kualitet të lartë dhe teknologji të avancuar.
3. Me datën 9 qershor 2023, Pala përgjegjëse ka dorëzuar në KPM kërkesë për ndryshim të pronësisë ku në certifikatën e regjistrimit të biznesit Fitnete Mujaj B.I. me emrin tregtar N.SH. "J@B-NET" me numër unik identifikues 810758196 me pronar znj. Fitnete Mujaj, vërehet se ka ndryshime fillimisht të emrit të biznesit në Optimum Telecommunications L.L.C si dhe llojin e biznesit nga biznes Individual në biznes Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (LLC) si dhe ndryshim të pronësisë, respektivisht të personit fizik si pronar, dhe kalimin nga znj. Fitnete Mujaj tek z. Erdidand Mujaj (djali i znj, Mujaj).
4. KPM bazuar në Raportin e departamentit të Licencimit të datës 13 nëntor 2023 ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Analiza ligjore

5. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe Rregullores 2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

6. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 3, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:

“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.”.

7. Në kundërshtim me nenin 7, të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2020/01, i cili përcakton se:

“ Licenca mund të bartet tek një palë tjetër vetëm pas miratimit paraprak me shkrim nga KPM-ja”.

8. Në kundërshtim me nenin 4, paragrafin 4.1, dhe 4.2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, i cili përcakton se:

4.1 Transferimi ose Dorëzimi i Licencës: I licencuari nuk mund të transferojë ose dorëzojë licencën pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së. Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të licencuarit kërkohet paraprakisht miratim me shkrim nga ana e KPM-së.”

4.2 Leja për transferimin: KPM do të lejojë transferimin e licencës vetëm pasi të jetë siguruar që kandidati të cilit propozohet që t'i transferohet licenca plotëson standardet e KPM-së për t'u pajisur me licencë të KPM-së.”

9. KPM bazuar në Raportin e departamentit të Licencimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse, ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së.

10. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafin 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 7, Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM – 2020/01, dhe nenin 4, paragrafin 1, dhe 2, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Vendim

11. Pala përgjegjëse të sanksionohet me **Gjobë** në shumën prej tremijë (3.000) euro në pajtim me 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjin të KPM-së, nenin 7 Shpërndarjen e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele KPM – 2020/01, nenit 4, paragrafin 4.1, dhe 4.2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
12. Pala përgjegjëse, obligohet që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi ta plotësoj kërkesën me dokumentet për ndryshim në pronësi, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 21, paragrafin 3 të Ligjin të KPM-së, nenin 7 Shpërndarjen e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele KPM – 2020/01, nenit 4, paragrafin 1, dhe 2 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI
Kryetar

24.11.2023

Datë

